

ZHVILLIMI RURAL DHE BUJQËSOR NJË PERSPEKTIVË PËR TË RINJTË NGA AGIA-CIA

20-24 qershor 2022

Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (ANRD) beson në rolin e rëndësishëm të rinisë shqiptare në zhvillimin dhe progresin e vendit tonë. Që prej dhjetorit të 2019, ANRD nisi të formojë **platformën e Qendrës së Rinisë Rurale (RYH)** me qëllim shprehjen e zërit të të rinjve në Shqipërinë rurale duke promovuar vetë-aktivizimin e rinisë rurale. Qendra do të mundësojë të rinjtë të përfshihen në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, e në veçanti në transformimin e komuniteteve të tyre rurale.

Në këto përpjekje, ANRD dhe organizata e saj partnere Volontari nel Mondo RTM do të mirëpresë në Shqipëri në muajin qershor dy nga përfaqësuesit më të lartë të organizatës AGIA-CIA (Shoqata e Sipërmarrësve të Rinj Bujqësorë të Konfederatës Italiane të Fermerëve), Presidentin z. Stefano Francia dhe zv. Presidenti Enrico Calentini. AGIA-CIA - një nga rrjetet më prestigjioze në Itali dhe Evropë, e themeluar në vitin 1977, përfaqëson më shumë se 900.000 fermerë italianë dhe sipërmarrës të biznesit rural. Ajo përfshin shoqata, agjenci dhe kompani që ofrojnë shërbime për të gjitha kategoritë e operatorëve të sektorit rural dhe bujqësor.

Duke marrë në konsideratë rolin e rëndësishëm të AGIA-CIA në sektorin bujqësor dhe rural në Itali dhe Evropë, ANRD dhe RTM do të organizojë disa aktivitete për të dëgjuar përvojën unike të AGIA-CIA dhe për të shkëmbyer dhe diskutuar me ta, duke u fokusuar në sfidat e proceseve reformuese të sektorit, veçanërisht në përfshirjen e të rinjve për të luajtur një rol aktiv në përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve rurale.

Vizita e përfaqësuesve të AGIA-CIA në Shqipëri

20-24 qershor 2022

Dita e parë, e Hënë 20 qershor 2022	
17:40 - 19:15	Nisja nga Bologna (Itali) dhe mbërritje në Rinas, Tiranë Akomodimi në Tiranë dhe briefing me Ekipin e Projektit
Dita e dytë, e Martë 21 qershor 2022	
10:30 - 11:00	Takim mirëseardhës në Universitetin Bujqësor të Tiranës me stafin kyç të UBT. Prezantimi i AGIA-CIA, përvojës së tyre dhe diskutimi mbi mundësitë e bashkëpunimit në të ardhshmen.
11:00 - 11:45	Vendi: Universiteti Bujqësor i Tiranës, Salla Skënder Xhiku nr 108, Godina e Agronomisë - Leksion i hapur: Zhvillimi Rural dhe Bujqësor – Një perspektivë për të Rinjtë në zonat rurale nga AGIA-CIA - Folës: Stefano Francia dhe Enrico Calentini
11:45 - 12:30	- Ndërveprim me pjesëmarrësit, Q&A
13:30 - 14:30	Dreka pranë fermës "Fustanella"
14:30 - 16:00	Vendi: "Fustanella Farm", Petrelë RURAL YOUTH TALKS: Përvoja italiane e AGIA-CIA për RYH, ANRD dhe organizatat anëtare rreth prioritetit tematik të rinisë rurale: nevoja dhe prioritete rinore në zhvillimin e qëndrueshëm rural në Shqipëri.
16:30 - 17:30	RYH në mbështetjen e rinisë rurale në zhvillimin bujqësor dhe rural – Mësimet nga eksperiencia e AGIA-CIA (organizimi, struktura, qasjet, etj.)
17:30 - 18:00	Sesion përmbyllës
19:30 - 21:00	Darkë e përbashkët (Pizza Time)
Dita e tretë, e Mërkurë 22 qershor 2022	
10:30 - 11:30	Vendi: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Takim trilateral me Zv Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Z. Enio Civici: Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – AGIA CIA - ANRD. <ul style="list-style-type: none">• Partneriteti ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë në mbështetje të rinisë rurale.• Prezantimi i Projektit 'Rural Albanian Youth - Rural You' dhe komponenti i Rrjetëzimit (ANRD mbështetje për RYH, AGIA-CIA)• Prezantimi i aktiviteteve dhe mundësive për sinergji me organizata si CEJA, etj.

10:00 - 11:30	Vendi: Liqeni Artificial i Tiranës (Pranë Anfiteatrit) Takimi i antarëve të RYH në zonën e Liqenit. Diskutim mbi strukturën dhe rolet e mundshme organizative.
11:30 - 13:30	Advokacia rinore për zhvillimin e qëndrueshëm rural – nevojat, interesat dhe aspiratat e të rinjve për komunitete rurale dinamike.
14:00 - 15:00	Drekë e përbashkët “Mullixhiu Restaurant”, Diga e Liqenit Artificial të Tiranës
15:00	Udhëtimi i kthimit (për antarët e RYH)
Dita e katërt, e Enjte 23 qershor 2022	
	Vizitë në Veri të Shqipërisë për AGIA-CIA në ferma dhe aktivitete që drejtohen nga antarët e RYH
Dita e pestë, e Premte 24 qershor 2022	
10:30 - 11:30	Debriefing me Ekipin e Projektit
15:20 - 17:05	Udhëtimi nga Rinas, Tiranë dhe mbërritje në Bologna (Itali)